



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 18.12.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Ganimete Musliu, Andin Hoti, Salih Zyba, Salih Salihu dhe Danush Ademi.

Munguan: Liburn Aliu, Etem Arifi dhe Sërgjan Mitroviq.

Të ftuar: Mevludin Krasniqi, Zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Kapllan Halimi Sekretar i përgjithshëm i MBPZHR-së dhe Ekrem Gjokaj, U.d. i Kryeshefit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB),

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja 11.12.2018;
3. Shqyrtimi i buxhetit të Ministrisë së bujqësisë për vitin 2019, i ftuar Ministri,
4. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, nga mbledhja e mbajtur më 11.12.2018

Muharrem Nitaj, kryetar, konstatoi se me 8 vota për, u miratua procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 11.12.2018, me disa vërejtje teknike të deputetit Salih Zyba.

3. Shqyrtimi i buxhetit të Ministrisë së Bujqësisë për vitin 2019, i ftuar Ministri;

Muharrem Nitaj, kryetar, njoftoi se për të diskutuar për buxhetin e Ministrisë së bujqësisë për vitin 2019, në komision janë përfaqësuesit e kësaj ministrie: Mevludin Krasniqi, Zëvendësministër, Kapllan Halimi Sekretar i përgjithshëm dhe Ekrem Gjokaj, u.d. kryeshef i Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë të cilëve u shprehu mirëseardhje. Ai shtoi se kemi kërkuar që ministri Rikallo të jetë në Komision dhe me gjasë ministri ka pasur arsye të agjendës apo arsye të tjera të cilat presim të na i tregojë zv. Ministri, mirëpo pasi që buxheti i ministrisë së bujqësisë është një qështje urgjente, kam kërkuar që në pamundësi që të vjen ministri atëherë të vijë zv.ministri dhe sekretari për të diskutuar këtë qështje.

Mevludin Krasniqi, Zëvendësministër i MBPZHR-së, për mungesën e ministrit Rikallo, tha se arsyeja e mungesës së tij është çështja politike aktuale, ndërsa shtoi se po mundohemi që me mundësitë që na lejon ligji ta zëvendësojmë dhe t'i kryejmë detyrat dhe obligimet tona që qytetarët dhe bujqit për asgjë të mos mbesin prapa. Ai e falënderoi komisionin për mbështetjen dhe mirëkuptimin për projektet e ministrisë dhe shtoi se e gjithë puna e mirë që është bërë, është edhe falë këtij komisioni.

Ai në vazhdim foli për buxhetin dhe prioritetet e ministrisë dhe filimisht tha se buxheti i MBPZHR-së për vitin 2019 është 61.3 milion € dhe shpërndarja e tij është si në vijim: 2.5 milion € për paga dhe meditime; 3.3 milion €, për mallra shërbime; 35 mijë € për komunal; 48 milion € për subvencione dhe transfere dhe 6.4 milion € për shpenzime kapitale. Ky buxhet është vazhdimësi e programit kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020, i cili është bazuar në Politikën e përbashkët bujqësore të BE-së dhe përbën 2 shtylla kryesore: subvencionet (pagesat direkte) me 24 milion € dhe grantet investive (projektet në zhvillimin rural) me 25 milion €.

Prioritetet e ministrisë do të jenë: Investimi në prodhimtarinë primare dhe modernizimin e fermave, investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale, përgatitja dhe zbatimi i strategjive zhvillimore, ujitja e tokave bujqësore, etj. Në kuadër të këtyre masave u ipen prioritet investimeve që krijojnë vende të punës me qëllim të ndikojë në parandalimin e migrimit nga zonat rurale, investimeve që trajtojnë mbrojtjen e ambientit, energjisë së ripërtëritshme, promovimit të fermave që menaxhohen nga femrat dhe të rinjtë.

Ky buxhet krahasuar me vendet e rajonit është më i ulët, por e ka ndihmu ekonominë e vendit, fermerin, industrinë e përpunimit dhe tash ka fillu edhe prodhimi i lëndës së parë në sektorin e perimeve dhe pemëve, e që nuk ka nevojë për import. Përfitimi nga grantet është rritë nga viti në vit : 2014-333 përfitues, 2015- 390 përfitues, 2016- 483 përfitues, 2017- 422 përfitues dhe në 2018-mbi 600 përfitues. Ndërsa për Investimet kapitale, ai shtoi se buxheti është i orientuar në sektorin e ujitjes dhe në infrastrukturën rrugore të vreshtave.

Besa Gaxherri, në fillim e kritikoi mospjesëmarrjen e ministrit në mbledhje dhe u fokusua te ndarjet të kësaj ministrie veçanërisht në kategorinë subvencione dhe transfere me 48 milion €, I cili është për zhvillimin e bujqësisë, por asnjëherë tha nuk kemi marrë raport nga auditori i brendshëm ose i jashtëm për këto shpenzime se a po ndahen drejtë dhe shtroi disa pyetje:

A është planifiku monitorim i hollësishëm i procesit të kontroleve të projekteve që kanë përfituar nga subvencionet? A është marrë ndonjë veprim që kriteret e vendosura në programin për zhvillimin e bujqësisë për pagesat diekte të janë në vijë me udhëzimet administrative që i rregullojnë këto programe? A është planifiku buxhet për shtim të stafit (pasi që në takimet që kemi pasë, ka pasë ankesa për mungesë të stafit, e që në këtë buxhet nuk është parashiku)? Pastaj vazhdoi te investimet kapitale, 6.4 milion €, shumat janë komplet të bartura nga viti 2018 në 2019 dhe shtroi pyetjen a mos ndoshta nuk është realizuar asnjë projekt dhe nuk është shpenzu hiq, dhe diku 15 projekte janë bartë në vitin 2019? Ndër to përmendi: ndërtimi dhe rehabilitimi i sitemit të ujitjes në Kosovë, blerja e pasisjeve për laboratorin e Institutit bujqësor të Kosovës.

Në fund ajo pyeti se a është planifiku buxhet për Ligjin për bujqësi organike dhe a ka ministria një strategji dhe program për sigurime nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi?

Kapllan Halimi Sekretar i përgjithshëm, duke iu përgjigjur pyetjeve tha se ndarja e buxhetit 48.1 milion € për subvencione dhe grante, është program kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural i detajuar dhe i hartuar ngushtë me *DG-Agriculture* (Drejtoria e përgjithshme për bujqësi) në Bruksel dhe kemi marrë vlerësim para dhe pas dhe programi hartohet për periudhë 7 vjeqare, tash jemi në fazën përfundimtare. Këtë vit është zhvilluar një hulumtim në teren me 2500 respondente (gjysma përfitues dhe gjysma jopërfitues) për të analizuar në mënyrë ekonometrike ndikimin e subvencioneve dhe granteve në territorin e Kosovës në rritjen ekonomike, punsueshmërisë dhe rritjen e ndalimit të migrimit nga zonat rurale në zonat urbane dhe raporti është në përfundim. Pastaj shtoi se Komisioni Evropian ka filluar vlerësimin e ndërmjetëm të këtij programi dhe të ndikimit të granteve dhe pagesave direkte në ekonominë e vendit. Keto dy dokumente do ju shpërndahen edhe deputetëve të shohin ndikimin pozitiv që ky sektor po e bën për ekonominë e vendit.

Sa i përket kontrollit ai përmendi dy vendime të ministrit: për kontrollin e të gjitha granteve investive që janë në periudhën monitoruese (periudha monitoruese është 5 vite) funksionimin e tyre, efektin e tyre dhe vështirësitë e fermerëve si dhe vendimin për kontrollin dhe numërimin e tërësishëm të koshereve të bletëve në Kosovë. Për investimet kapitale, tha se nuk janë investime të njejta por është kategori e njejtë e shënuar, për arsye se nuk mund të mbulohet brenda vitit i gjithë investimi, këtu përmendi Institutin Bujqësor të Kosovës ku janë planifikuar paisje laboratorike 250 mijë € dhe investimin gradual në të gjitha paisjet laboratorike dhe ky është instituti me aparaturën më moderne në regjion me kuadër të mirë dhe mbulon po thuaj se të gjitha analizat në mbrojtjen e bimëve. Ndërsa për sektorin organik ai tha se është në rritje dhe vetëm këtë vit ka rritje për 250 ha, ky sektor përkrahet me pagesa direkte dhe grante investive dhe po thuaj se të gjithë eksportin në bujqësi e mbulon ky sektor.

Ganimete Musliu, pasi tha që në rend dite kemi buxhetin e ministrisë së bujqësisë për vitin 2019 i shtroi disa pyetje konkrete: sa janë të kënaqur me mundësitë buxhetore për vitin 2019, cilat janë kërkesat konkrete dhe a janë adresu kërkesat e ministrisë në komision dhe çka mundet komisioni me ndihmu gjatë amendamentimit të buxhetit si dhe pyeti pse akoma Agjencia për zhvillimin e bujqësisë është me ushtrues detyre të kryeshefit ?

Salih Salihu, buxheti për bujqësi është i njejtë me një rritje të vogël për 1.4 milion €, por nuk është në proporcion me rritjen e buxhetit të Kosovës. Ai në vazhdim bëri një krahasim dhe tha se në vitin 2015 buxheti për bujqësi ka qenë 3.6 %, ndërsa tash 2.6%, duke e ditë është sektor shumë i rëndësishëm që mund të kontribuojë në GDP e vendit dhe duke marrë parasysh se sektori i bujqësisë dhe i ushqimit përfshinë gati 1 miliard € konsum, duke i marrë parasysh edhe rrethanat që kemi me vendet fqinjë dhe taksën 100%, është dashtë që buxheti për bujqësi me u rritë dukshëm në 100 milion €. Në kuadër të këtij buxheti ai propozoi një fond zhvillimor me së paku 20 milion € për vit e nga kjo do të ngriteshin 20 fabrika dhe për 5 vitë do të ngriheshin 100 fabrika, të cilat përmes kredive të buta me ju dhënë qytetareve dhe për 5 vite do të punësoheshin rreth 33 mijë punëtorë dhe kështu do të rritej prodhimin vendor dhe të zvoglohej importi. Për Institutin Bujqësor tha se është model dhe ka teknologji të avancuar, ndërsa përmendi problemet me pagesat për dëmet nga të reshurat për fermeret dhe që ende nuk janë pagu dhe pyeti a ka parapa MBPZHR-ja buxhet të veqantë për dëmet për këtë kategori?

Muharrem Nitaj, duke u ndërlidhë më konstatimin e deputetit Salihu, tha se buxheti i Kosovës për vitin 2019 është rritë, ndërsa buxheti i Ministrisë është i njejtë dhe duke e pasë parasysh këtë rritje të buxhetit të Kosovës ai pyeti përfaqësuesit e ministrisë pse nuk ka rritje edhe për buxhetin e bujqësisë, a nuk është bujqësia prioritet apo nuk është planifiku si duhet, atëherë dikush duhet të na jep përgjigje përmbajtësore për këtë.

Salih Zyba, së pari tha se ka insistuar që ministri Rikallo të jetë prezent për raportim në Komision, pasi që ai në takimin e fundit ka shpreh gatishmërinë “që sa herë të kërkohet do të raportojë në komision” dhe të sjellë disa raporte: për dëmet nga të reshurat në bujqësi ai ka sjellë vetëm raportin 3 mujor, pastaj përgjegjen me shkrim për sistemin mbrojtjes kundër breshërit. Prandaj në mungesë të ministrit ai kërkoi përgjegjen nga përfaqësuesit e ministrisë, për këto dy raporte. Ndërsa ai tha

se nuk mjafton arsyetimi për mungesën e ministrit me “*çështjet aktuale politike*” dhe pyeti se a del ministri dhe stafi i tij politik në punë? Ndërsa në vazhdim nuk u pajtua me vendimin për kontrollin e koshereve të bletëve dhe pyeti si mund të kontrollohen dhe të hapen kosheret në këtë stinë? Pastaj vazhdoi me disa pyetje: për mospajtimin e tregut për fermerët; cilat janë projektet konkrete ose risi për investimet te sektori i ujëtjes? çfarë investimesh parashihen te infrastruktura rrugore për vreshtat? çka është bërë konkretisht për sigurimet bujqësore? Pastaj tha se këtu mungon edhe kryeshefi i Agjencionit të pyjeve dhe në fund ai u shpreh i pakënaqur me përmbajtjen e uebfaqes së ministrisë sepse i mungon freskimi i sajë.

Andin Hoti, pasi u pajtua me pyetjet e deputetëve paraprak dhe shtroi disa pyetje: a janë nda rezerva për dëmet në bujqësi dhe sa mendohet të jetë ai buxhet për kompenzimin e këtyre dëmeve; Sa është buxheti i veçantë për grante investive; A është finalizu programi për grante dhe subvencione vitin 2019? Për programin e veçantë për fermerët e vegjël, e përsëriti kërkesën e tij të mëhershme që të zhvendoset ky program nga komunat e veriut, në regjionin e Prizrenit dhe Rahovecit dhe pyeti kur do të bartet dhe sa është buxheti i këtij programi. Në fund tha se Qeveria ka marrë vendim të kompenzohen të gjitha dëmet në komunën e Rahovecit dhe Therandës dhe pasi që kjo nuk është bërë, atëherë kur do të kompenzohen?

Përfaqësuesit e MBPZHR-së, iu përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të komisionit:

Zëvendësministri Krasniqi, për buxhetin e bujqësisë tha se, edhe pse ka pasë rritje ndër vite, është më i vogël në regjion dhe ka nevojë të rritet sidomos në sektorin e granteve në lëminë e agropërpunimit të pemëve dhe perimeve dhe të prodhimit të lëndës së parë. Ministria ka kapacitet për menaxhimin e projekteve dhe menaxhimi i mirë ka sjellë mbi 600 fitues të granteve. Shuma për grantet investive është 25.6 milion €. Për kompenzimin e dëmeve, tha se jemi në pritje të rialokimit të mjeteve, pasi që ka ky vit ka qenë me shumë të reshura sidomos në komunat Rahovec, Suharekë, Ferizaj, Mamushë, etj dhe në mungesë të buxhetit nga ministria, Qeveria ka formuar komisionin ndërministror në përberje: Zyra e kryeministrit, Ministria e financave dhe Ministria e bujqësisë, të cilët janë duke punuar për të gjetur zgjidhje kompenzimit të dëmeve dhe për të gjetur zgjidhje afatgjate për të ardhmen. Për pozitën e u.d kryeshefit të Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë, tha se përgjegjës është këshilli për emërimet të larta, ndërsa për ministrin e MBPZHR-së tha se ai po thuhet se çdo ditë del në punë dhe i kryen detyrat e veta ligjore, ndërsa aktivitetet në ministri nuk kanë mbetur mbrapa. Për investimet në sistemin e ujëtjes te Drini në zonën e Hasit dhe Rahovecit dhe të Radoniqi- Dukagjini, tha se janë në fazën e implementimit të projekteve dhe gjithashtu në bashkëpunim me Bankën botërore është duke u përgatitë plani nacional për shtimin e ujëtjes.

Vazhdoi **Kapllan Halimi**, për projektin për rregullimin e stazave në zonën vreshtare (Rahovec, Suharekë, Malishevë, Prizren, Gjakovë) do të ketë investime në infrastrukturën rrugore dhe hapjes së mundësisë për hyrjen e makinerisë, traktorave të vegjël me crast do të ulëj kostoja e mbjelljes dhe vjeljes. Për buxhetin e ministrisë, tha se kërkesa buxhetore e ministrisë i është dërguar Ministrisë së financave vit me vlerë mbi 100 milion €, mirëpo falë bashkëpunimit të mirë me shumë donatorë bëhet kompenzimi i atyre pjesëve që nuk mbulohej nga buxheti. Për raportin 6 mujor të vërshimeve dhe dëmeve, tha se është dërguar në qeveri dhe jemi në pritje të rialokimit të mjeteve që kompenzimi për fermerë të bëhet nga qeveria. Ndërsa për raportin e mbrojtjes raketore, kërkoi falje, por tha se kemi kërku ekspertizë më të thellë para se të ju kthejmë një përgjigje.

Programi për zonat më pak të zhvilluara për fermerë të vegjël dhe ata ekzistencial do të bëhet në gjithë territorin e Kosovës. Ndërsa pajtohet se duhet të rifreskohet uebfaqja e ministrisë, por shtoi se përveq uebfaqes së ministrisë, janë edhe ajo e AZHB-së dhe të shërbimit këshillimor dhe ka pasë shumë aktivitete që nuk janë paraqitur në uebfaqe dhe besoj se nga janari do ta bëhet një rifreskim i sajë.

Për sigurimet në bujqësi tha se IFC nga Banka botërore ka bërë një studim mbi bazën e vendosjes së produkteve bujqësore nën sigurim, për arsye se nuk mundet që as fondi emergjent dhe asnjë fond të jetë afatgjatë. Për ofrimin e mbështetjes së fermerit për mosdëmtim dhe bashkë me IFC kemi krijuar një program për subvecionimin e primit për sigurimet në bujqësi. Në bashkëpunim me

Bankën botërore në fillim do ti ndihmojmë fermerit me një pjesëmarrje të pagesës së primit, dhe fermeri do të paguajë një pjesë të vogël për arsye financiare.

Vazhdoi **Ekrem Gjokaj**, për sigurimet në bujqësi shtoi se kemi përgatitë tërë dokumentacionin e nevojshëm, kemi arritë një marrëveshje që të shkojmë me sigurimin index, pasi që nuk kemi kapacitete të kompanive të sigurimeve që të shkohet me sigurimin e përgjithshëm. Janë përzgjedhë kulturat e caktuara dhe faktorët klimatike, sic janë: ngricat, reshjet me përmbytje, breshëri dhe bora e vonshme. Nga kjo, Ministria do ta paguajë 50% të primit ndërsa fermeri i cili është i interesuar participon me 50%. Në lidhje me pyetjen a janë realizu pagesat direkte: deri në kto momente shtoi ai janë paguar 25.8 milion € për të gjitha masat dhe përfitues kanë qenë 27 mijë fermerë dhe jemi në pritje te rialokimit të buxhetit nga Ministria e financave për 3.2 milion € për pagesat e fundit. Për programin e vitit 2019, tha se është në fazën finale dhe në janar të vitit të ardhshëm do të jetë i gatshëm, ndërsa fokusi ynë ka qenë rritja e prodhimtarisë primare si parakusht për rritjen e kapaciteteve ta agropërpunimit.

Në fund Gjokaj, tha, nëse arrihet me zvoglu për 50% importi i ujit të pijes (*që është 50 milion € në baza vjetore*) atëherë do të mund krijohet fondi që e propozoi deputeti *Salihu*, për të cilin tha se është bërë një studim fizibiliteti por që ka mungu mbështetja politike.

Kryetari **Nitaj**, në fund i falënderoi për pjesëmarrjen, zëvendësministrin Krasniqi, sekretarin Halimi dhe kryeshefën Gjokaj, duke kërkuar që në vitin 2019 të ketë më shumë bashkëpunim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Muharrem Nitaj